



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 539, datë 12.10.2023

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z. {...}, NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës Administrative të Apelit, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 23.10.2026.
2. Ngarkohet Zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykatë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit, z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës Administrative e Shkallës së parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR